

STATUTI I

SHOQËRISË TREGTARE “D&S Distribution” SHPK

Sot më datë 28.02.2025, ne themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila do të ketë emërtimin tregtar “D&S Distribution”.

Themeluesit e shoqërisë janë:

1. Z. **Dritan Bellaj**, i datëlindjes 12.05.1970, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, madhor, shtetas shqiptar, mbajtës i Letërnjoftimit me nr. 036084667 dhe nr. Personal H0052112BE.
2. Z. **Suad Lici**, i datëlindjes 24.03.1974, lindur në Shkodër dhe banues në Shkodër, madhor, shtetas shqiptar, mbajtës i Letërnjoftimit me nr. 036608500 dhe nr. Personal H40324081U.

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Themelimi

1.1 Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emrin “D&S Distribution” shpk, e cila është organizuar dhe do të funksionojë në përputhje me kërkesat e këtij Statuti dhe legjislacionit Shqiptar në fuqi. Shoqëria do të fitojë personalitet juridik, pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

1.2 Shoqëria ka vulën dhe logon e saj, në të cilën shënohet emri si dhe selia e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë. Në të gjitha aktet ose dokumentat që u drejtohen të tretëve duhet të figurojnë këto emërtime tregtare me qëllim identifikimin e Shoqërisë në qarkullimin civil.

Neni 2

Forma juridike

2.1 Shoqëria “D&S Distribution” SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (këtu e më tej referuar si “Shoqëria”). Ortakët e Shoqërisë janë persona juridikë, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e Shoqërisë dhe mbulojnë personalisht humbjet e Shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

2.2 Kontributet e ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar të Shoqërisë.

Neni 3

Selia

3.1 Shoqëria ka selinë e saj në adresën: Rr. Jashar Skenderi, Komuna Kashar, Fushe Mezez, Autostrada Tirane-Durres, km1, Tiranë, Shqipëri.

3.2 Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në territorin e qarkut Shkodër.

3.3 Shoqëria nëpërmjet një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme mund të ndryshojë selinë e saj brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

3.3 Asambleja e Përgjithshme, nëse e konsideron të nevojshme dhe në interes të shoqërisë, mund të hapë filiale dhe degë të tjera në Shqipëri dhe t'i mbyllë ato, kur e konsideron se shkaqet e hapjes së tyre nuk ekzistojnë më.

Neni 4

Kohëzgjatja e aktivitetit

Aktivitetit i Shoqërisë do të ushtrohet për një periudhë 5 vjecare, deri në 31.12.2029.

Neni 5

Objekti i veprimtarisë

5.1 Objekti i shoqërisë është veprimtaria në fushën e distribucionit të produkteve ushqimore, pijeve alkoolike dhe jo alkoolike, pijeve të buta, bazuar në veprimtarinë e planifikuar, brenda territorit të Qarkut Shkoder me perjashtim të rrjeteve të supermarketeve të organizuara.

5.2 Për përmbushjen e objektit të veprimtarisë, shoqëria mund të ushtrojë veprimtarinë e saj tregtare me shoqëri të tjera që kanë objekt të njëjtë ose të përafërt me të sajën dhe mund të kryejë direkt apo indirekt të gjitha operacionet tregtare, financiare, me karakter të luajtshëm e të paluajtshëm.

5.3 Shoqëria mund të hapë dhe të mbajë llogari rrjedhëse në lekë apo valuta të tjera, pranë bankave shqiptare, duke mundur gjithashtu të disponojë lirisht mjetet monetare të akumuluar në llogaritë e saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 6

Ndalimi i konkurrencës



2



Ndalimi i përmendur në nenin 17 të ligjit 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, i ndryshuar” nuk zbatohet dhe ortakët dhe administratoret e Shoqërisë mund të emërohen për të ushtruar funksione administrimi në shoqëri të tjera tregtare ose të veprojnë si tregtarë duke patur një aktivitet të njëjtë me atë të Shoqërisë nëse janë të autorizuar me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Gjithashtu ndalohet ushtrimi i aktivitetit tregtar, përkatësisht tregtimi i produkteve, objekt i veprimtarisë tregtare, jashtë rrjetit të Mapo City.

KREU II

Kapitali Themeltar dhe Kuota

Neni 7

Kapitali dhe kuotat

7.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 1.000.000 (një milion) Lekë

7.2 Ky kapital themeltar është i ndarë në 2 kuota me vlerë nominale, si më poshtë vijon në nenin 7.3, dhe që përbëjnë 100% të kapitalit themeltar.

7.3 Kuotat do të zotërohen nga ortakët sipas ndarjes së mëposhtme:

- **Z. Dritan Bellaj** – zotëron 1 kuotë të barazvlefshme me vlerën 760.000 (shtatëqind e gjashtedhjetë mijë) Lekë, e barazvlefshme me 76% të pjesëmarrjes në Shoqëri;
- **Z. Suad Lici** – zotëron 1 kuotë të barazvlefshme me vlerën 240.000 (dyqind e dyzet mijë) Lekë, e barazvlefshme me 24% të pjesëmarrjes në Shoqëri.

7.4 Kontributi i Ortakëve në Shoqëri do të paguhet në para nga secili prej ortakëve të shoqërisë.

Neni 8

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

8.1 Zmadhimi i kapitalit themeltar vendoset nga Asambleja me vendimarrjen e ortakëve që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave të ortakëve pjesëmarrës. Pas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme për zmadhimin e kapitalit, ortakët brenda 30 ditëve duhet të bëjnë derdhjet respektive, në proporcion me kuotën e kapitalit që zotëron secili.

8.2 Depozitimi i kapitalit të zmadhuar, bëhet vetëm nga ortaku/ët që kanë votuar pro rritjes së kapitalit, secili sipas kuotës që është vendosur në asamble. Në mungesë të marrëveshjes për rindarjen e kuotave, barazohet me 100 (njëqind) shuma e kapitalit pas zmadhimit. Pas derdhjes së kontributeve të sipërpërmendura, Administratori/ët duhet të regjistrojnë në librin e ortakut zmadhimin e kapitalit, duke marrë dhe nënshkrimin e tij.

8.3 Administratori/ët në bazë të ligjit dhe pa autorizim paraprak të Asamblesë, mund t'u kërkojnë informacione ortakut kur ai ka nënshkruar zmadhimin e kapitalit, në lidhje me derdhjen e kontributeve brenda afatit të sipërpërmendur.

8.4 Zvogëlimi i kapitalit vendoset nga Asambleja me vendimarrjen e ortakëve që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave të ortakëve pjesëmarrës.

8.5 Kur vendimi i zvogëlimit të kapitalit nuk motivohet nga humbjet në aktive, kreditorët e shoqërisë duhen njoftuar menjëherë. Kreditorët kanë të drejtë të kundërshtojnë vendimin pranë organeve gjyqësore.

Neni 9

Transferimi i kapitalit themetar dhe e drejta e parablerjes

9.1 Ortakët që zotërojnë më pak se 50% të kuotave të kapitalit themeltar të Shoqërisë, mund t'ua shesin, transferojnë ose dhurojnë pjesët e tyre të kapitalit personave të tretë, vetëm me miratimin me shkrim të ortakëve që zotërojnë së bashku ose veçmas të paktën 50% të kuotave të Shoqërisë dhe vetëm nëse ua kanë ofruar më parë për shitje ortakëve të tjerë të Shoqërisë me kushte jo me pak të favorshme nga ato që ju ofrohen të tretëve. Oferta u komunikohet me shkrim ortakëve të cilën kanë të drejtën e parablerjes, e drejtë që duhet ta ushtrojnë brenda 60 ditëve nga data e komunikimit.

9.2 Nëse në përfundim të afatit 60 ditor asnjëri nga ortakët me të drejtë parablerje nuk e ka ushtruar këtë të drejtë, shitësi duhet të informojë administratorin për identitetin e personit të tretë që do të blejë kuotat që janë vënë në shitje nga ortaku. Administratori brenda 7 ditësh duhet të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme për të vendosur në lidhje me propozimin për shitje të kuotave të personave të tretë. Nëse administratori nuk e thërret Asamblenë, Asambleja mund të thërret nga ortaku i interesuar.

9.3 Pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në Shoqëri me miratimin e shumicës së ortakëve që përfaqësojnë të paktën tre të katërtat e pjesëve të kapitalit themeltar.

9.4 Në rast se Shoqëria nuk ka bërë të ditur vendimin e saj brenda tre muajve nga data e njoftimit të fundit sipas paragrafit të mësipërm, miratimi i transferimit konsiderohet i dhënë.

9.5 Në rast se Shoqëria refuzon të japë miratimin e transferimit, ortakët brenda tre muajve nga data e këtij refuzimi, mund të ushtrojnë të drejtën e parablerjes. Në përfundim të këtij afati ortaku që kërkon të shesë kuotat e tij do të ketë të drejtë t'ia shesë ato personave të tretë.

9.6 Shitja e pjesëve të kapitalit te të tretët pa respektuar kriteret e treguara më sipër në këtë nen është e pavlefshme dhe nuk mund të sjellë pasoja kundrejt ortakëve dhe Shoqërisë.

9.7 Transferimi (kalimi) i kuotës mund të bëhet me kontratë shitblerje, me kontratë dhurimi, me trashëgimi, dhe në çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

KREU III

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Neni 10

Të drejta dhe detyrimet

10.1 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë.

10.2 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në vendimmarrje dhe disponon një numër votash në raport me pjesën e kapitalit themeltar që ai zotëron.

10.3 Vendimet e asamblesë së përgjithshme merren në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Statutin e saj dhe janë të detyrueshme për të gjitha organet e shoqërisë. Vendimet e asamblesë protokollohen në një regjistër të veçantë në përputhje me ligjin.

10.4 Asambleja ka të drejtë të ushtrojë në çdo moment verifikime mbi Administratorin/ët dhe të kontrollojë çdo dokument të shoqërisë. Ajo mund të urdhërojë apo të udhëzojë administratorin/ët në kryerjen e detyrës së tij/tyre.

Neni 11

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

11.1 Asambleja e përgjithshme e ortakëve mbledhet në rastet e përcaktuara në ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, dhe/ose në dispozitat e këtij statuti si dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e Shoqërisë.

11.2 Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme së Ortakëve thirret të paktën një herë në vit.

11.3 Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratorët e Shoqërisë apo ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë në rastin kur ndodhin ngjarjet e parashikuara në nenin 84.1 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008" Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

11.4 Asambleja e Përgjithshme thirret nëse sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vijim.



Neni 12

Thirrja e Asmblesë

12.1 Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet njoftimit me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Në njoftimin e mbledhjes drejtuar ortakëve duhet të jetë caktuar vendi ku do të zhvillohet mbledhja, si dhe data, ora, rendi i ditës. Së bashku me njoftimin për mbledhje, ortakëve duhet t'u dërgohen dhe dokumentat për çështjet që do të shqyrtohen. Njoftimi i mbledhjes duhet t'u dërgohet ortakëve jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhje.

12.2 Kur mbledhja e asamblesë nuk është thirrur sipas mënyrës së përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni, atëherë mund të merren vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime pavarësisht parregullsisë së njoftimit.

Neni 13

Përfaqësimi në Asamble

Ortaku mund të përfaqësohet në Mbledhjen e Asamblesë nga një ortak tjetër apo nga një person tjetër në bazë të një autorizimi, i cili jepet vetëm për një mbledhje.

Kur administratorët e Shoqërisë nuk janë ortakë, ata nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në Mbledhjen e Asamblesë.

Neni 14

Marrja e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme

14.1 Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- Vendos për përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë dhe strategjive të zhvillimit, përfshirë edhe investimet kapitale;
- Vendos për ndryshimet e statutit;
- Emëron dhe shkarkon Administratorin/ët, likuiduesit dhe audituesit ligjorë, si dhe përcakton shpërblimet e tyre;
- Mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare nga Administratori/ët, miraton buxhetin vjetor të shoqërisë dhe raportet e ecures së veprimtarisë;
- Vendos për zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- Vendos për pjesëtimin e kuotave dhe/ose anulimin e tyre;
- Vendos për riorganizimin (shndërrimin, bashkimin ose ndarjen e shoqërisë);
- Vendos prishjen e shoqërisë dhe kalimin e saj në likuidim;
- Vendos për transferimin (blerjen, shitjen dhurimin, shkëmbimin) e pasurive të shoqërisë, për cedimin apo për dhënien me qira të shoqërisë ose degëve të saj, për dhënien me qera të aseteve të shoqërisë, për marrjen me qera të objekteve apo aseteve të ndryshme, për kontratat leasing, për

- pjesëmarrjen në kapitalin e kompanive të tjera nëpërmjet pjesëmarrjes në kapital, blerjes së kuotave apo aksioneve;
- Vendos për miratimin e huamarrjeve me interes nga të tretët, si dhe për huamarrjet pa interes;
 - Vendos për dhënien e garancive hipotekore, pengut, barrëve siguruese, dorëzanimet etj;
 - Miraton Bilancet, pasqyrat financiare dhe raportet e audituesve ligjorë;
 - Miraton shpërndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve, vendos për ndarjen e dividendit ose për kapitalizimin e tyre nëpërmjet zmadhimit të kapitalit;
 - Miraton strukturën organizative të shoqërisë, rregulloren e brendshme dhe organigramën, rregulloren e sigurimit teknik, si dhe politikat dhe nivelin e pagave dhe shpërblimeve për çdo vend pune në shoqëri;
 - Vendos për çështje të tjera të parashikuara nga ligji;

14.2 Bazuar në nenin 86/1 dhe 87/2 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 50% të kuotave të Shoqërisë. Çdo vendim i shoqërisë sipas Statutit dhe ligjit do të merret me shumicë të kualifikuar. Pra Asambleja mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht në mbledhje dhe tri të katërtat e ortakëve pjesëmarrës votojnë pro vendimarrjes. Çdo ortak disponon një numër votash të barabartë me pjesët e kapitalit themeltar që ai zotëron.

14.3 Në rast se nuk arrihet Kuorumi i përcaktuar më sipër, Asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

14.4 Bazuar në nenin 86 dhe 87 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve me 90% të votave të ortakëve pjesëmarrës sipas nenit 14 më lart, për të gjitha çështjet e përcaktuara në Statut dhe në ligj.

Neni 15

E drejta e votës

15.1 Çdo kuotë jep të drejtën e një vote.

15.2 Ortakët, që nuk janë të pranishëm, kanë mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.

16.3 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga Shoqëria;
- d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Neni 16

Procesverbalet e mbledhjes

Vendimet e marra nga asambleja e përgjithshme e ortakëve evidentohen në një regjistër që depozitohet në selinë e Shoqërisë. Procesverbali duhet të përmbajë datën dhe vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit. Procesverbalit i bashkëngjitet edhe lista e pjesëmarrësve dhe akti i thirrjes si dhe në fund nënshkruhet nga kryetari dhe mbajtësi i procesverbalit.

KREU IV

ADMINISTRIMI

Neni 17

Administrimi i Shoqërisë

17.1 Shoqëria do të administrohet nga një Administrator, i zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve. Afati i emërimit të administratorit është 5 vjet, përveç rasteve të shkarkimit nga ortakët, dorëheqjes ose revokimit në çfarëdo kohe nga ana e tij. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

17.2 Personi i mëposhtëm do të caktohet si Administrator i Shoqërisë:

1. **Z. Suad Lici**, i datëlindjes 24.03.1974, lindur në Shkodër dhe banues në Shkodër, madhor, shtetas shqiptar, mbajtës i Letërnjoftimit me nr. 036608500 dhe nr. Personal H40324081U.

17.3 Administratori merr vendime në bazë dhe për zbatim të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë, si dhe të këtij statuti. Administratori gëzon kompetenca të pakufizuara për realizimin e objektivit të veprimtarisë së shoqërisë, me përjashtim të atyre kompetencave që Statuti ia njeh Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

17.4 Administratori do të ushtrojë kompetencat e përcaktuara në nenin 19 të këtij statuti.

Neni 18

Kompetencat e Administratorit

18.1 Administratori gëzon të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:

- a. të kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare dhe në Rregulloren e miratuar nga Asambleja e Ortakëve;
- b. të komunikojë dhe të hyj në marrëdhënie tregtare me palë të treta;
- c. të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, kur kërcënohet veprimtaria dhe ekzistenca e shoqërisë;
- d. të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithme për të gjitha detyrat lidhur me politikat tregtare, dhe pengesat që kanë hasur për zbatimin e tyre, propozimet konkrete për të përmirësuar gjendjen;
- e. të zhvillojë aktivitete marketingu në çdo sektor tjetër, veprimtari ndërmjetësimesh, studimesh, bashkëpunimi, për të zhvilluar nisma ekonomike;
- f. të kryejë të gjitha veprimet pranë të gjitha zyrave shtetërore apo private;
- g. të kryejë veprime depozitimi, kreditimi, pagesa e arkëtime në bankë sipas Rregullores së Miratuar nga Asambleja dhe në përputhje me limitet specifike;
- h. të kryejë regjistrimet dhe të dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- i. përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta;
- j. të lëshojë autorizime dhe/ose prokura të përgjithshme dhe/ose të veçanta për akte të përcaktuara ose kategori aktesh, duke i dhënë përfaqësuesit të autorizuar pushtetin e nevojshëm për arritjen e qëllimit të tagrit specifik;
- k. të marrë pjesë në ankande private e publike, si dhe çdo veprim tjetër në shërbim të realizimit të objektivit të shoqërisë;
- l. t'i dorëzojë ortakëve një dokument vërtetues për sasinë e shumave të derdhura nga ortakët, kur kërkohet nga këta të fundit;
- m. të përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve t'ia paraqesë asamblesë së përgjithshme për miratim;

18.2 Administratori kryen edhe detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut si edhe mund të vërë në lëvizje organe administrative dhe gjyqësore, duke autorizuar avokatë dhe lëshuar autorizime në raste mosmarrëveshjes gjyqësore, duke kryer të gjitha operacionet e nevojshme bankare, përfshirë këtu edhe

hapjen e llogarive rrjedhëse, nënshkrimin dhe xhirimin e çeqeve, realizimin e tërheqjeve, depozitimeve, transfertave, xhirimeve dhe pagesave.

18.3 Administratori mund të emërojë përfaqësues, të cilëve, individualisht apo kolektivisht, mund t'iu japë të drejtën e firmës, duke i përcaktuar kompetencat, shpërblimet dhe garancitë që do të vlerësojë të arsyeshme. Ai mundet gjithashtu të emërojë drejtues ose përfaqësues për akte apo kategori aktesh të caktuara.

Neni 19 **Përgjegjësitë e Administratorit**

19.1 Administratori (apo administratorët nëse do të emërohen të tillë) janë përgjegjës individualisht ose solidarisht, sipas rastit, ndaj shoqërisë ose të tretëve, për shkeljet ligjore të Statutit apo faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

19.2 Shoqëria nuk është përgjegjëse ndaj të tretëve, për aktivitete dhe transaksione të kryera nga administratori në kapërcim të kompetencave të tij, kur vërtetohet se ata ishin në dijeni të kësaj rrethane.

19.3 Administratori përgjigjet personalisht para shoqërisë dhe/ose të tretëve që kanë pësuar dëme nga ndonjë veprim i tij i paligjshëm.

19.4 Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme, duke e shoqëruar me motivacionin përkatës. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorëve, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

19.5 Administratori/ët mund të heqi/in dorë në çdo kohë nga detyra e tij/tyre, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar Asamblesë së Përgjithshme. Administratori/rët, që paraqet dorëheqjen, është gjithashtu i detyruar të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme për emërimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja e tij të ketë hyrë në fuqi.

19.6 Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk vendos emërimin e administratorit të ri në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga administratori i dorëhequr, atëherë administratori i njofton me shkrim dorëheqjen "Qendrës Kombëtare të Biznesit", së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme.

KREU V

LLOGARITË VJETORE DHE RAPORTI I ADMINISTRIMIT

Neni 20

Audituesi ligjor

20.1 Emërimi i audituesve ligjor bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përcakton mandatin dhe shpërblimin.

Kur ligji e parashikon shprehimisht prezencën e audituesit ligjor, janë të pavlefshme veprimet/operacionet e kryera pa prezencën e tij.

20.2 Audituesi ligjor pasi ka verifikuar librat kontabël, arkën dhe depozitat bankare, garanton që kontabiliteti vjetor është mbajtur në rregull, i korrespondon të vërtetës dhe është në përputhje me legjislacionit në fuqi.

Audituesi ligjor mund të shkarkohet nga funksionet e tij me vendim të Asamblesë së Përgjithshme si dhe me vendim gjykatë.

Audituesi ligjor përpilon dhe i paraqet Asamblesë një raport financiar mbi ushtrimin vjetor që pasqyron situatën financiare në nisje dhe atë në mbyllje.

Ai kontrollon që bilanci përfundimtar dhe Raporti i përpiluar nga Administratori për Asamblenë, t'i korrespondojë realitetit.

Audituesi ligjor është i detyruar t'i paraqesë Administratorit dhe Asamblesë së ortakëve:

- a) Kontrollat, verifikimet dhe sondazhet e bëra;
- b) Zërat e bilancit dhe dokumentacionin kontabël që duhet korrigjuar duke sugjeruar edhe zgjidhjet;
- c) Gabimet dhe pasaktësitë e konstatuara;
- d) Rezultatin financiar pas korrigjimeve të bëra;

Ai duhet të thirret në të gjitha mbledhjet e Asamblesë së ortakëve ku aprovohet bilanci i aktivitetit vjetor, por mund të thirret edhe në të gjitha rastet kur konsiderohet e nevojshme.

20.3 Audituesi ligjor përgjigjet ndaj shoqërisë dhe ndaj të tretëve për pasojat e negative që rrjedhin nga gabime e neglizhime në kryerjen e funksionit të tij.

Nuk mban përgjegjësi për shkeljet ligjore të kryera nga administratori, me përjashtim të rasteve kur ka pasur dijeni për to, por nuk ia ka paraqitur dhe raportuar para asamblesë.

Neni 21

Llogaritë vjetore

21.1 Veprimet ekonomiko-financiare të Shoqërisë fillojnë më datën 1 Janar dhe mbarojnë më datën 31 Dhjetor të çdo viti. Përjashtimisht viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

21.2 Kapitali fillestar i investuar nga ortakët e Shoqërisë përbën bazën e krijimit të fondit themelor dhe mjeteve të xhiros.

21.3 Bilanci vjetor miratohet brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit financiar për vitin e mbyllur nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.

Neni 22

Fitimi dhe fondet rezervë

22.1 Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimet e realizuara gjatë vitit financiar të sapo mbyllur. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë për formimin dhe shpërndarjen e fondeve të ndryshme.

22.2 Asambleja e Përgjithshme vetëm pasi ka miratuar bilancin përfundimtar dhe ka vendosur shumën që do të shpërndahet, përcakton pjesën e fitimit për ortakun e vetëm.

Shoqëria mund t'i shpërndajë fitime ortakut të vetëm, vetëm nëse administratori apo administratorët, nën përgjegjësinë e tyre personale, lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat nenit 77 të Ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Gjate vitit, shoqëria ka të drejtë t'i japë ortakut të vetëm paradhënie mbi dividendët në vlera jo më të mëdha se dividendi i shpërndarë një vit më parë, me kusht që:

- a) Të mbetet e depozituar një rezervë, e barabartë me paradhëniet që do të shpërndahen;
- b) Një auditues ligjor të vërtetojë me një relacion me shkrim që fitimet neto të realizuara deri në atë moment janë më të mëdha se paradhëniet që parashikohen për t'u shpërndarë ortakëve.

Shpërndarja e paradhënieve vendoset nga Asambleja ose administratori. Në vendimin përkatës duhet të specifikohen shumat dhe datat e kthimit. Dividendët që nuk korrespondojnë me fitimet e realizuara realisht, mund t'iu reklamohen ortakëve që i kanë marrë ato.

KREU VI

PRISHJA OSE RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 23

Shkaqet e prishjes së Shoqërisë

23.1 Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë nga Asambleja e Ortakëve me shumicë të cilësuar:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë;
- d) me vendim të gjykatës;
- dh) për arsye të tjera, të parashikuara në statut.

23.2 Administratori regjistron prishjen e Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Nëse prishja bëhet me vendim gjykate, ky vendim i njoftohet Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim.

KREU VII

LARGIMI DHE PËRJASHTIMI I ORTAKËVE

Neni 24

Largimi dhe përjashtimi i Ortakëve

Ortaku mund të largohet nga Shoqëria nëse:

- a. ortakët e tjerë ose Shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij;
- b. është penguar të ushtrojë të drejtat e tij;
- c. është ngarkuar me detyrime të paarsyeshme;
- d. shkaqe të tjera të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.

Neni 25

Procedura e largimit të ortakut

25.1 Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë Shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtojë shkaqet e largimit. Në bazë të këtij njoftimi, administratorët duhet të thërrasin mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në të cilën duhet të vendoset nëse do t'i likujdohet kuotat si pasojë e largimit.

25.2 Ortaku ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë ndaj Shoqërisë për likujdimin e kuotës, në rast se asambleja nuk mblidhet apo nuk i njeh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likujdimin e kuotës si dhe ka të drejtë të kërkojë nga Shoqëria shpërblimin e dëmit të pësuar nga largimi i tij.

25.3 Ortaku duhet të dëmshpërblejë Shoqërinë nëse largimi i tij është bërë në bazë të shkaqeve të paarsyeshme.

Neni 26

Përfshirja e Ortakut

26.1 Asambleja e Ortakëve mund t'i kërkojë gjykatës përfshirjen e ortakut nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përfshirje.

26.2 Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përfshirjen e ortakut, sipas pikës 1 të këtij neni, por pa u kufizuar në to, rastet kur ortakut:

- a) me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë;
- b) me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj;
- c) përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut; ose
- ç) me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë.

KREU VIII
LIKUIDIMI NË GJENDJEN E AFTËSISË PAGUESE

Neni 27

Likuidimi

Prishja e shoqërisë tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedure falimentimi.

Neni 28

Emërim i likuidatorit

28.1 Likuidimi i Shoqërisë bëhet nga likuiduesi i emëruar nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve. Nëse Asambleja nuk merr vendim për emërimin e likuiduesit, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

28.2 Kur shoqëria priset me vendim gjykate, likuiduesi caktohet nga gjykata.

Neni 29

Të drejtat dhe detyrimet e likuiduesit

29.1 Likuiduesi është përgjegjës për mbylljen e të gjitha veprimeve të likuidimit të Shoqërisë, mbledhjen e kredive të paarkëtuara dhe kontributeve të pashlyera, shitjen e pasurive të Shoqërisë dhe likuidimin e kreditorëve duke respektuar rradhën e preferimit të parashikuar në nenin 605 të Kodit Civil.

29.2 Pas shlyerjes së detyrimeve të Shoqërisë ndaj kreditorëve, likuiduesi i paraqet Asamblese së Përgjithshme një raport për procedure e likuidimit, detyrimet e shlyera dhe për shpërblimin e tij.

29.3 Kapitali i mbetur pas shlyerjes së detyrimeve të Shoqërisë ndaj kreditorëve, i kalon ortakëve të cilët miratojnë mbylljen e Shoqërisë.

29.4 Likuiduesi kryen veprimet e çrregjistrimit të Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

KAPITULLI IX
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 30

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin ose interpretimin e këtij statuti, si dhe çdo mosmarrëveshje që mund të lind midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Neni 31

Ndryshimet në Statut


31.1 Dispozitat e këtij Statuti mund të ndryshohen nga Asambleja e Ortakëve, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

31.2 Çdo dispozitë e Aktit të Themelimit që vjen në kundërshtim me këtë Statut do të jetë e pavlefshme dhe në çdo rast Statuti do të ketë përparësi mbi Aktin e Themelimit të Shoqërisë.

31.3 Ky Statut është përpiluar dhe nënshkruar nga ortakët e Shoqërisë në 4 kopje origjinale me qëllim përshtatjen e tij me Ligjin nr.9901, date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

ORTAKËT

Z. Dritan Bellaj



(emër, mbiemër, firmë)

Z. Suad Lici




(emër, mbiemër, firmë)